



DREJTORIA E
PËRGJITHSHME
E TATIMEVE



European Bank
for Reconstruction and Development

INFORMACION PËR TATIMPAGUESIT

Person Fizik me xhiro
mbi 8 milionë Lekë

Person Fizik me xhiro mbi 8 milionë lekë

1. Quhesh Person Fizik nëse:

- a. Je një individ dhe kërkon që të ushtrosh një aktivitet tregtar të pavarur;
- b. Je i vetëpunësuar, i vetëm dhe/ose me punëmarrës anëtarë të papaguar të familjes dhe persona të tjera.
- c. Regjistrohesh në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) si person fizik;

Për detaje kliko në faqen elektronike të QKB:

<http://www.qkb.gov.al/informacion-mbi-proceduren/regjistri-i-biznesit/regjistrimi-fillestar/>

2. Regjistrimi i biznesit në QKB është i detyrueshëm:

- a. Gjithmonë para nisjes efektive të veprimtarisë së biznesit tënd.

3. Vendet ku mund të regjistrohesh:

- a. Në sportelet e QKB-së ose të autorizuara prej saj në bashki dhe dhomat e tregtisë;
- b. Në sportelet e Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruar (ADISA); dhe,
- c. Në platformën elektronike e-albania.



4. Për regjistrimin e biznesit kërkohen disa dokumenta dhe të dhëna të detyrueshme:

a. Dokumentat:

- i. Kartë identiteti e personit që do të regjistrohet;

Kujdes: Në platformën e-albania ndiq udhëzimet për mënyrën e aplikimit.

b. Të dhënat minimale të detyrueshme për t'u përfshirë në kërkesën për regjistrim:

- i. Lloji i aktivitetit ekonomik;
- ii. Adresa e vendit të biznesit;
- iii. Statusi si i vetëpunësuar i vetëm dhe/ose me punëmarrës anëtarë të papaguar të familjes apo punëmarrës të tjerë;

Kujdes: Një individ, mund të regjistrohet vetëm një herë në QKB si Person Fizik. Për çdo shtim veprimitarje, pajisesh me të njëtin NIPT me numër serial të ndryshëm.

c. Xhiroja vjetore e parashikuar:

Përbën bazën mbi të cilën përcaktohen detyrimet/përgjegjësitë tatimore të personit fizik që në momentin e regjistrimit.

Më poshtë paraqiten llojet e detyrimeve tatimore sipas nivelit të xhiros.

Tabela 1 – Llojet e detyrimeve tatimore në varësi të xhiros vjetore të biznesit

Xhiroja Vjetore (Në lekë)	Përgjegjësitë tatimore / Llojet e Detyrimeve Tatimore				
	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe TAP	Tatim mbi Vlerën e Shtuar (TVSh)	Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin	Tatim Mbi Fitimin	Tatimi në Burim
0-2 milionë	Po	Jo	Po	Jo	Po
Mbi 2 deri 5 milionë	Po	Po	Po	Jo	Po
Mbi 5 deri 8 milionë	Po	Po	Po	Jo	Po
Mbi 8 milionë	Po	Po	Jo	Po	Po

5. Procesi i regjistrimit në QKB përfundon mbasi ke:

- a. Plotësuar dhe dorëzuar formularin e regjistrimit me të dhënat e mësipërme;
- b. Marrë çertifikatën e regjistrimit me numrin unik të identifikimit, që quhet Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT).

Ky proces zgjat një ditë pune.

Të nesërmen mund të verifikosh statusin e kërkesës për regjistrim duke klikuar në faqen elektronike të QKB-së: <http://www.qkb.gov.al>

- Në rast se kërkesa pezullohet, ke 21 ditë kohë për të plotësuar mangësitë.
- Në rast se kërkesa e regjistrimit refuzohet, bëhet kërkesë e re, pas eleminimit të shkaqeve të refuzimit.

6. Regjistrimi i biznesit në QKB është njëkohësisht edhe:

Regjistrim në Administratën e Tatimeve, Doganave, Bashkive dhe Inspektoratit të Punës.

7. Menjëherë pas regjistrimit fillestar në QKB:

- a. Hap dhe regjistro llogarinë tënde në faqen elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) duke përdorur:
 - i. NIPT-in, si emër përdoruesi, dhe
 - ii. "Tatimetemia12", si fjalëkalim fillestar.

Kujdes:

1. Përgjegjësitet tatimore fillojnë nga data e regjistrimit në QKB.
2. Verifiko dhe qartësohu për përgjegjësitet tatimore të listuara në kategorinë "Profil i im".
3. Deklarimet për detyrimet tatimore bëhen vetëm nëpërmjet kësaj llogarie elektronike.
4. Nëse ke probleme gjatë regjistrimit dhe përdorimit të llogarisë tënde elektronike:
 - a) Telefono Qendrën e Thirrjeve të DPT në numrin e telefonit 0800 00 02;
 - b) Merr udhëzime drejtësëdrejti në seksionin "live chat" të këtij shërbimi;
 - c) Paraqitu personalisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT), ose

Kliko në faqen elektronike të DPT:

<https://www.tatime.gov.al/c/7/200/ udhezues-perdorimi>

8. Menjëherë pas hapjes të llogarisë elektronike në DPT:

- a. Deklaro në llogarinë tënde elektronike:
 - i. Jo më vonë se 2 ditë pas regjistrimit në QKB, vetëm veten tënde, nëse ke të punësuar dhe punonjës të papaguar të familjes mbi 16 vjeç;

REGJISTRIMI I TATIMPAGUESVE

Detyrimi për t'u regjistruar
Regjistrimi në gendrën kombëtare të biznesit (QKB)
Regjistrimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore
Regjistrimi i Organizateve lojtarinprurëse
Entet Publike.
Përlanësuesi tatimor
Amlulantë
Kryefamilipari
Fermeri
Individet

- ii. Jo më vonë se 3 ditë përpara afatit të paraqitjes së deklaratës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore vetëm veten tënde, nëse nuk ke të punësuar dhe punonjës të papaguar të familjes mbi 16 vjeç. Në këtë rast llogaritja e detyrimit fillon që nga data e regjistrimit në QKB.
- b. Shko pranë zyrës së taksave vendore të Bashkisë tënde:
 - i. Dorëzo një kopje të aktit të pronësisë/kontratës së qerasë për vendin/vendet e biznesit; dhe
 - ii. Kërko njoftimin për llojet, shumat dhe afatet e pagesës së taksave të tua vendore.

i. Dorëzo një kopje të aktit të pronësisë/kontratës së qerasë për vendin/vendet e biznesit.

(Ky dokument mund të dorëzohet edhe elektronikisht nëpërmjet llogarisë së deklarimit elektronik në www.tatime.gov.al)

Kujdes: Nëse ambientin e merr me qera, pronari duhet të ketë paguar taksën e pasurisë së paluajtshme.

- c. Shko në DRT për:
 - i. T'u pajisur me bllokun e faturave tatimore të shitjes me TVSh, dëftesat tatimore dhe faturat e shoqërimit të mallit; dhe
 - ii. Dorëzo një kopje të aktit të pronësisë/kontratës së qerasë për vendin/vendet e biznesit.
(Ky dokument mund të dorëzohet edhe elektronikisht nëpërmjet llogarisë së deklarimit elektronik në www.tatime.gov.al)
- d. Shkarko modelin e deklarimit të librave të blerjes dhe shitjes, nga seksioni "Librat e shitjeve dhe blerjeve" në llogarinë tënde elektronike në DPT;
- e. Brenda 15 ditëve nga data e regjistrimit duhet të pajisesh me kasë fiskale, pranë shoqërive të autorizuara, nëse do të shesësh me para në dorë;

Kujdes: Deri në ditën e pajisjes me kasë fiskale dhe/ose në rast se kasa fiskale është jashtë funksionit, duhet të lëshosh dëftesë tatimore për çdo shitje të kryer.

- f. Hap llogari bankare në emër të Personit Fizik për arkëtimet dhe pagesat e biznesit tënd.

Kujdes: Nuk mund të bëhen transaksione me para në dorë për shuma mbi 150,000 lekë midis dy personave tregtarë fizikë apo juridikë.

9. Në marrëdhënie me Administratën Tatimore ke të drejtë për:

- a. Informim dhe sqarim për legjislacionin;
- b. Ruajtjen e konfidencialitetit të tē dhënave tua;
- c. Marrje njoftimi paraprakisht për aktet që lidhen me detyrimet tatimore;
- d. Kontrolle tatimore në kohë të arsyeshme, në vendin e duhur dhe brenda afateve të ligjit;
- e. T'u dëgjuar para marrjes së vendimeve që lidhen me biznesin tенд;
- f. Të marrë informacion nga dosja jote tatimore;
- g. Përfaqësim me persona të autorizuar prej teje;
- h. Ankimin ndaj vepprimeve dhe mosveprimeve të administratës;
- i. Një shqyrtim të pavarur administrativ të ankesave të bëra;
- j. Marrë ose printuar nga sistemi elektronik (e-albania) vërtetime për:
 - i. Përgjegjësitë tatimore;
 - ii. Detyrimet e paguara;
 - iii. Pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
 - iv. Xhiron e 3 viteve të fundit;
 - v. Statusin si tatimpagues (aktiv, pasiv) dhe afatet konkrete për secilin rast;
 - vi. Posedim mjeti;
 - vii. Për regjistrim të investitorit;
 - viii. Për kontributet e paguara për individin;
 - ix. Vërtetim për individë të paregjistruar.

10. Dokumentat që duhen afishuar në ambientet e biznesit:

- a. Certifikata e Regjistrimit (NIPT-i);
- b. Lista e çmimeve të shitjes për çdo mall/ shërbim që ofron;
- c. Njoftim-kujdes për klientët që të marrin kuponin tatimor për blerjet me para në dorë si dhe që kanë të drejtë për të mos kryer transaksionin për vlerën e mallit ose shërbimit të ofruar, nëse shitësi nuk lëshon faturën tatimore ose kuponin tatimor.



11. Për dokumentimin e shitjeve dhe blerjeve duhet të:

- a. Lëshosh kupon tatimor për çdo shitje me para në dorë;
- b. Lëshosh faturë tatimore shitje me TVSh, së bashku me kuponin tatimor kur:
 - i. Shet mallra apo ofron shërbime me vlerë mbi 40.000 lekë;
 - ii. Bën shitje tek një tregtar tjetër, dhe
 - iii. Blerësi individ të kërkon vetë një faturë tatimore me TVSh.
- c. Lësho faturë tatimore shitje me TVSh në rast se:
 - i. Shet mallra ose kryen shërbime me pagesë të mëvonshme në bankë;
 - ii. Arkëton paradhënie për shitje mallrash ose kryerje shërbimesh në një datë të mëvonshme.
- d. Lësho faturë tatimore nga blloku yt, me shënimin "Faturë e lëshuar nga blerësi", për blerjet që bën nga individë, persona fizikë jo-tregtarë, dhe shëno në të numrin e kartës së identitetit të tij, në mënyrë që fatura të jetë e vlefshme për qëllime tatimore;
- e. Plotëso faturat e shitjes me të gjitha të dhënat e kërkua: datën, të dhënat e blerësit, emrin tregtar/emrin e individit, NIPT/Nr. personal, adresën, transportuesin, përshkrimin e mallit/ shërbimit, njësinë, çmimin pa TVSh, vlerën pa TVSh, shumën e TVSh, etj;
- f. Bëj mbylljen e kasës fiskale, në fund të çdo dite pune dhe transmeto të dhënat e saj. Të nesërmen regjistrimi i kuponave fillon nga e para;
- g. Merr faturë tatimore të thjeshtë ose me TVSh (në varësi të përgjegjësisë tatimore të shitësit) për çdo blerje të kryer për biznesin tënd.

Kujdes: Blerjet pa faturë tatimore ose vetëm me kupon tatimor, nuk njihen si shpenzime të zbritshme.

Moslëshimi i faturës/kuponit tatimor të përfshin automatisht në listën e subjekteve me risk dhe në rast përsëritje ndiqesh penalisht për evazion.

12. Deklarimi i të punësuarve dhe të larguarve nga puna dhe i pagave të tyre:

- a. Marrja në punë dhe largimi nga puna deklarohen në llogarinë elektronike:
 - i. 1 ditë para marrjes në punë, dhe
 - ii. Brenda 10 ditëve nga data e largimit nga puna.
- b. Njihen si shpenzime të zbritshme vetëm pagat që paguhen nëpërmjet sistemit bankar.

13. Detyrimet Tatimore që duhen paguar

Shuma e detyrimeve tatimore llogaritet duke shumëzuar shumën (bazën) mbi të cilën llogaritet tatimi me shkallën tatimore të caktuar për secilin lloj të tatimit.

Tabela 2–Detyrimet Tatimore për personat fizikë me xhiro vjetore mbi 8 milionë Lekë

Nr.	Lloji i Detyrimit	Shkalla Tatimore	Shuma mbi të cilën zbatohet shkalla tatimore
1.	Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSh)	6% 20%	Vlera për shërbimin e akomodimit Vlera per shërbimin e akomodimit dhe restorantit, përveç pijeve, për strukturat e agroturizmit; Vlera per shërbimin e reklamave nga media audiovizive; Vlera e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve me mbi nëntë plus një vende me motor elektrik, deri në 31.12.2021; Vlera e librave të çdo lloji; Vlera e mallrave/shërbimeve të tjera
2.	Kontribute për sigurime shoqërore për të vetëpunësuarin dhe punonjës të papaguar të familjes	23%	Paga për efekt sigurimi, por jo nën pagën minimale dhe mbi pagën maksimale mujore (26,000-114,670 lekë)
3.	Kontribute për sigurime shëndetësore për të vetëpunësuarin dhe punonjës të papaguar të familjes	3,4%	Dyfishi i pagës minimale mujore (2x26,000 lekë)
4.	Kontribute për sigurime shoqërore të punëmarrësit	24.5%	Paga mujore faktike bruto por jo nën pagën minimale dhe jo mbi pagën maksimale mujore (26,000-114,670 lekë)
5.	Kontribute për sigurime shëndetësore të punëmarrësit	3.4%	Paga mujore faktike bruto por jo nën pagën minimale mujore (26,000 lekë)
6.	Tatim mbi të ardhurat nga punësimi të punëmarrësit	0% 13% 23%	Paga mujore bruto deri në 30,000 lekë; Pjesa e pagës mujore bruto mbi 30,000-150,000 lekë Pjesa e pagës mujore bruto mbi 150,000 lekë
7.	Tatim mbi fitimin	5% 15%	Fitimi bruto (para tatimit), per xhiro vjetore deri në 14,000,000 lekë; Fitimi bruto (para tatimit), per xhiro vjetore mbi 14,000,000 lekë;
8.	Tatim në burim	15%	Shuma bruto e pagesës për individë të paregjistruar

14. Periudhat dhe mënyra e deklarimit të Detyrimeve Tatimore

Periudhat për të cilën bëhet deklarimi i detyrimeve tatimore varen nga lloji i detyrimit

Tabela 3 - Periudha dhe mënyra e deklarimit të Detyrimeve Tatimore

Nr.	Lloji i Detyrimit Tatimor	Periudha që mbulon deklarata	Mënyra e paraqitjes së deklaratës
1.	Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)	Mujore	Online
2.	Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore/TAP	Mujore	Online
3.	Tatimi mbi fitimin	Vjetore	Online
4.	Tatimi në burim	Mujore	Online

15. Afatet e deklarimit dhe pagesës së Detyrimeve Tatimore

Afati i deklarimit të detyrimeve tatimore është i ndryshëm në varësi të llojit të detyrimit. Data e fundit e deklarimit është edhe data e kryerjes së pagesës. Më poshtë janë dhënë datat e fundit të deklarimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore dhe vendi i kryerjes së pagesës.

Tabela 4 - Afatet e deklarimit dhe pagesës si edhe vendi ku kryhet pagesa e Detyrimeve Tatimore

Nr.	Lloji i Detyrimit Tatimor	Afati i deklarimit dhe pagesës së detyrimit	Vendi i pagesës
1.	Tatimi mbi vlerën e shtuar	Çdo muaj, brënda datës 14 të muajit pasardhës	Në bankë
2.	Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore/ TAP	Çdo muaj, brenda datës 20 të muajit pasardhës	Në bankë
3.	Pagesa e kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin	Brenda datës 30 të çdo tremujori (30 Mars; 30 Qershor; 30 Shtator; 30 Dhjetor)	Në bankë
4.	Tatimi mbi fitimin	Brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës	Në bankë
5.	Tatimi në burim	Çdo muaj, brenda datës 20 të muajit pasardhës	Në bankë

Kujdes: Deklarata e TVSh, plotësohet në bazë të librit mujor të shitjes/blerjes, që dorëzohet online brenda datës 10 të muajit pasardhës;

Nëse detyrimet tatimore janë krijuar si rezultat i vlerësimit të bërë nga administrata tatimore duhet të paguhen brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

16. Ndryshimet e Deklaratave Tatimore për gabime ose pasaktësi bëhen nëse:

- Nuk kanë kaluar më shumë se 36 muaj nga deklarimi fillestar dhe nuk je kontrolluar nga administrata tatimore gjatë kësaj kohe;
- Je kontrolluar nga tatimet, por deklaron një detyrim tatimor më të madh se sa kontrolli;

17. Detyrimet mund të paguhen edhe me këste nëse:

- Je në vështirësi financiare;
- Lidh një marrëveshje për kushtet e pagesës me këste me DRT;
- Parapaguan 20% të detyrimit;
- Garanton mbylljen e detyrimeve brenda muajit Dhjetor të vitit pasardhës, në të kundërt marrëveshja nuk pranohet ose kërcohët të vendosësh garanci bankare.


Kujdes: Marrëveshja e pagesës me këste mund të prishet në çdo kohë nëse:

- Pagesat nuk bëhen në përputhje me marrëveshjen;
 - Nuk paguan detyrimet e reja që lindin pas marrëveshjes;
- Nuk pranohet të lidhet marrëveshje e pagesës me këste për detyrim tatimor të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, i cili është llogaritur, ose mbledhur, ose mbajtur prej tij, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

18. Deyrimet Tatimore të paguara tepër rimbursohen ose kompensohen:

A. Rimbursimet:

- Bëj kërkesë nëse rezulton me tepricë kreditore, në DPT për TVSh dhe në DRT për tatime të tjera;
- Merr miratimin nga DPT,



- pas vlerësimit nga zyra ose me kontroll të thelluar në vend për TVSh;
- c. Kërko dhe prit transferimin në llogarinë tënde bankare:
- Brenda pesë ditëve, pas dërgimit të urdhër-pagesës në sistemin e thesarit nga DPT;
 - Brenda 5 ditëve pas miratimit të shumës për reimbursim të bazuar në kontrollin në vend;
 - Brenda 30 ditëve, për diferencën pas mbulimit të detyrimeve të papaguara.

B. Kompensimet:

- Shuma e mbipaguar ose miratuar për reimbursim kalon për llogari të detyrimeve të tjera të papaguara:
 - Brenda periudhës vijuese tatimore pas asaj në të cilën tatimpaguesi rezulton me kredi tatimore;
 - Për tatimin mbi fitimin, brenda muajit të parë që pason muajin në të cilin personi i tatushëm rezulton me kredi tatimore
 - Për llogari të detyrimeve tatimore të ardhshme të tatimpaguesit.

Kujdes: Rimburimi bëhet me një urdhër-pagesë në degën e thesarit, nga DPT për TVSh-në dhe DRT për tatimet e tjera, ndërsa kompensimi bëhet automatikisht për detyrimin e radhës të të njëjtit lloj dhe me miratim të posaçëm për llogari të detyrimeve të tjera, përveç mbipagesës së kontributeve për sigurimet.

19. Mosdekclarimi i Detyrimit Tatimore dhe mospagesa në afat kanë kosto:

- Vendoset gjobë për mosdekclarim;
- Pas 5 ditëve, nga data e detyrimit për të deklaruar, administrata tatimore të njofton me letër kujtesë për detyrimin;
- Brenda 10 ditëve pas njoftimit administrata tatimore bën vlerësim automatik të deklaratës së munguar, i cili:
 - Nuk mund të ankimohet, por
 - Mund të anulohet nëse paraqet deklaratën brenda afatit të ri të përcaktuar.
- Sistemi elektronik fillon llogaritjen automatike të gjobave dhe kamatëvonesave për detyrimin e papaguar.

20. Afati dhe pagesa e Detyrimeve të Taksave dhe Tarifave Vendore

- Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore përcaktohen me ligj dhe me Vendimet e Këshillave Bashkiake (VKB);
- Taksat vendore llogariten dhe paguhën në bazë vjetore, përveç vitit të regjistrimit ose pushimit/çregjistrimit të aktivitetit që llogariten proporcionalisht për periudhën e vitit fiskal që biznesi është aktiv;

- c. Taksat dhe Tarifat ndryshojnë sipas llojit të biznesit dhe natyrës së veprimtarisë së tij, por më tipiket janë:
- Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, ku përfshihen ndërtesat dhe tokat bujqësore;
 - Tarifat e pastrimit, zënies së hapësirave publike, tabelës dhe të tjera që vendosen me VKB.

21. Ndryshimi i përgjegjësive tatimore

- Si pagues i tatim fitmit nuk të lejohet ndryshimi i përgjegjësive tatimore edhe nëse xhiroja vjetore e biznesit zbret nën 8 milionë lekë;
- Në varësi të fushës së aktivitetit, mund të duhet të regjistrohesh edhe për përgjegjësi tatimore të tjera specifike siç janë renta minerare, taksat kombëtare dhe tarifat kombëtare.

22. Ndryshime të organizimit dhe vendndodhjes që duhen regjistruar në QKB

- Ndryshimi i adresës së biznesit.
- Hapja/mbyllja e adreses sekondare.
- Ndryshim/shtimi i objektit të veprimtarisë.

Ndryshimet deklarohen në QKB nga personi fizik ose çdo person i autorizuar prej tij.

Kujdes: Mos fillo aktivitet në adresë dytësore, pa kryer më parë regjistrimin në QKB.

- Merr kasë fiskale për çdo adresë dytësore nëse kryen shitje me para në dorë.
- Konsiderohen si adresë dytësore edhe mjetet për:
 - Shitjen e mallrave derë më derë dhe
 - Transportin e mallrave dhe udhëtarëve për të tretë.
- Për mjetet e shoqërisë që përdoren vetëm për transportin e mallrave për vete ose blerësin tënd merr një vërtetim për posedim mjeti, online në portalin e-albania.

23. Mbajtja e të dhënave tatimore dhe kontabël

- Dokumentat që duhet të mbahen për qëllime tatimore janë:
faturat e blerjes



- dhe shitjes, librat e blerjeve dhe shitjeve, inventari i mallrave, libri i aktiveve të biznesit dhe çdo regjistrim tjetër i kërkuar nga ligji tatimor dhe i kontabilitetit;
- b. Dokumentat tatimore ruhen për një periudhë 5-vjeçare nga data e mbylljes së vitit fiskal.
 - c. Kontabiliteti dhe përgatitja e pasqyrave financiare vjetore bazohen në ligjin për kontabilitetin dhe standardet e aplikueshme të raportimit financier;
 - d. Pasqyrat Financiare ngarkohen online në llogarinë e tatimpaguesit brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës;
 - e. Pasqyrat Financiare duhet të ngarkohen online në QKB, nëpërmjet platformës e-albania, brenda datës 31 Korrik të vitit pasardhës.

Kujdes: Nëse plotëson kushtet për Deklaratën e Transferimit të çmimit, duhet ta depozitosh atë brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

24. Kontrolli tatimor

- a. Administrata tatimore ka të drejtë të kontrollojë deklaratat tatimore, llogaritë, librat dhe regjistrimet tatimore të tatimpaguesit, përfshirë të gjithë dokumentacionin, që ka të bëjë me pasqyrat financiare;
- b. Llojet e kontrollit tatimor janë:
 - i. Kontroll i thelluar në vend, me njoftim paraprak 30 ditë;
 - ii. Vizita fiskale, me njoftim paraprak 10 ditë;
 - iii. Verifikim në terren, pa njoftim paraprak por me një urdhër ditor të punës.

25. Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor bëhet kur:

- a. Detyrimet tatimore nuk janë paguar sipas afateve ligjore;
- b. Nuk ke ushtruar të drejtën e ankimit në Drejtorinë e Apelimit Tatimor (DAT);
- c. Kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor.

Për mbledhjen ndërmerrën këto hapa:

- i. Njoftimi i tatimpaguesit me kërkësë për të paguar/ Urdhër bllokim i llogarive bankare me postë rekomande ose në rrugë elektronike/ sigurimi i detyrimit tatimor me vendosjen e barrës siguruese dhe/ose barrës hipotekore/ sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së bllokuar/ shitja e pasurisë së sekuestruar/ kalimi i përgjegjësisë për detyrimin e papaguar tek palët e treta, administratorët dhe ortakët.
- ii. Pas dërgimit të Njoftimit dhe kërkësës për Pagesë, mund të merret masa e konfiskimit deri në 50% të xhiros ditore;
- iii. Kërkohet pezullim i veprimeve në QKB dhe Doganë.

26. Ankimimi bëhet:

- a. Pranë DAT të Ministrisë së Financave dhe të Bashkisë;
- b. Për vlerësimet e bëra nga administrata tatemore dhe çdo vendim tjetër që ndikon në detyrimin tatemor, përveç vlerësimit të bërë në mungesë të deklaratës tatemore;
- c. Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit;
- d. Pas pagesës ose vendosjes së garancisë për detyrimin që ankimohej, por jo për kamatëvonesat dhe gjobat.
- e. Edhe në rrugë gjyqësore kur akti është ankumuar më parë në rrugë administrative.

27. Gjobat dhe kamatëvonesat:

- a. Vendosen për deklarime dhe pagesa të detyrimeve tatemore përtrej afateve ligjore;
- b. Aplikohen edhe për fshehje të detyrimit, moslëshim të faturave të shitjes dhe/ose kuponit tatemor, mosdekclarim të pagës reale, plotësim të gabuar të deklaratave tatemore, mosinstalimin dhe mosmirëmbajtjen e pajisjeve fiskale, mosdekclarim të punonjësve, mosmbajtje të dokumentave tatemore/kontabël, etj.;
- c. Zbatohen të dyja së bashku, por kamatëvonesat fillojnë nga afati i pagesës dhe ndërpritën në datën e pagesës së detyrimit;
- d. Ndërsa gjobat mund të ankimohej, kamatëvonesat jo.

Kujdes: Fshehja apo shmangja nga pagimi i detyrimeve tatemore, për shkaqet e mësipërme, përvçe klasifikohen si evazion fiskal mund të bëhen edhe objekt i ndjekjes penale.

28. Kalimi në statusin pasiv tatemor:

- a. Mund të bëhet vetëm nga DRT nëse:
 - i. Pezullon aktivitetin duke aplikuar në QKB, për një afat të caktuar ose jo;
 - ii. Nuk dorëzon deklaratën tatemore përgjatë 12 muajve të fundit;
 - iii. Dorëzon deklarata tatemore pa aktivitet për 12 muaj të njëpasnjëshëm;
- b. Të lejon ndërprerjen e deklaratave për të gjithë llojet e detyrimeve tatemore;
- c. Kërkon dorëzimin në DRT të numrave serial të blloqeve të faturave të shitjes të papërdorura.

Kujdes:

- a. Nuk pezullon dot aktivitetin në QKB, pa paguar më parë të gjitha detyrimet tatemore;
 - b. Në statusin pasiv nuk mund të kryesh asnjë aktivitet;
 - c. Duhet të dorëzosh deklaratën e tatemit mbi fitimin dhe Pasqyrat Financiare për muajt e vitit në aktivitet.
- Për rifillimin e aktivitetit duhet të aplikosh në QKB. Kur kalimi në statusin pasiv është bërë direkt nga DRT, raktivizimi bëhet me kërkesë pranë administratës tatemore.

29. Çregjistrimi bëhet:

- a. Deklaron vullnetarisht mbylljen e aktivitetit pranë QKB-së;
- b. Paraqet deklaratat tatimore të muajit të fundit, deklaratën vjetore të tatimit mbi fitimin, pasqyrat financiare dhe vendimin e personit Fizik;
- c. Shlyen detyrimet tatimore ndaj administratës tatimore dhe Bashkisë ;
- d. Brenda 30 ditëve nga aplikimi për mbylljen e aktivitetit, nëse nuk ke detyrime të papaguara.

Kujdes:

- a. Edhe pas çregjistrimit mbetesh përgjegjës për detyrimet e mbeturë ndaj të tretëve dhe ndaj autoriteteve publike.
- b. Dorëzo pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore blloket e faturave të shitjes të papërdorura.
- c. Pas çregjistrimit në QKB, kontakt shoqërinë e autorizuar të kasës fiskale për çaktivizimin e saj.

Ky material është përgatitur në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe përban informacion mbi të drejtat dhe detyrimet tatimore për kategorinë:

**Person Fizik me xhiro
mbi 8 milionë Lekë**

Qendra e thirrjeve: 0800 00 02 (pa pagesë)

Orari: E Hëne - E Enjte ora 08:30-18:00; E Premte ora 08:30 -16:00

 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Web: www.tatime.gov.al



**European Bank
for Reconstruction and Development**



DREJTORIA E
PERGJITHSHME
E TATIMEVE